



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 36, datë 03.07.2025

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS BASHKISË Durrës DHE SPITALLA SOLAR SHPK ME QËLLIM TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, KËSAJ SHOQËRIE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË PARKUT FOTOVOLTAIK TË SPITALLËS ME NJË KAPACITET PREJ 100 MEGAVAT ENERGJI

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, VKM-së nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 18.11.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të pronës shtetërore me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën Ish-Kënetës, Spitallë, ndryshuar me VKM-në nr.478, datë 13.07.2022, është përcaktuar sipërfaqja e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik të shpallur me VKM-në nr. 262, datë 06.04.2016 “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës” sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë “Spitalla Solar” Shpk me objekt transferimin e së drejtës të përdorimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të ndodhura brenda vendndodhjes sipas hartës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej Tij, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë “Spitalla Solar” Shpk me objekt transferimin e së drejtës të përdorimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të ndodhura brenda vendndodhjes sipas hartës bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, Drejtoria Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja Rruga, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS



Denisa Luarasi

U shpall sot me datë 03.07.2025



EPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË _____

NR. REP.

NR. KOL.



**MARRËVESHJE
BASHKËPUNIMI**



SPITALLA SOLAR

Sot, më ____/____/2025, para meje, noterit publik _____ me adresë në _____, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një Parku Fotovoltaik 100 MËp dhe infrastruktura elektrike përkatëse ne Spitalle, Durres, Shqipëri ("**Projekti**") midis palëve të mëposhtme:

BASHKIA DURRES, me adresë: Sheshi "Iliria", Durres, Shqipëri, përfaqësuar nga Kryetaria **Znj. Emiriana Sako**, duke vepruar në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. _____ datë _____;

Këtu e në vijim "Bashkia",

dhe

SPITALLA SOLAR sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M11609003K, me seli në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", Ndërtesa ETC, Kati 14, Njësia Administrative Nr. 2,1000, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga njëri nga **Znj. Kelly CLUTTERBUCK**;

Këtu e në vijim "SPV" dhe se bashku me Bashkinë këtu e në vijim referuar si "Palët" dhe veç e veç si "Pala".

Kushtet paraparake:

- A. Projekti është dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri ("**MIE**") në favor të Voltalia SA ("**Voltalia**") në zbatim të procedurës konkurruese të ankandit ndërkombëtar për projektimin, ndërtimin, instalimin, komisionimin, financimin, operimin, përmirësimi dhe mirëmbajtja e impiantit fotovoltaik dhe infrastrukturës së shërbimit përfitues panelet fotovoltaike të vendosura në Spitalle, Durres, Shqipëri. Për këtë qëllim, Marrëveshja e Zhvillimit të Projektit ("**MZHP**") u nënshkrua më 31 Maj 2020 dhe Marrëveshja



Perfundimtare për Zhvillimin e Projektit ("MPZHP") u nënshkrua më 20 Dhjetor 2024, midis Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri ("MIE") dhe Voltalia SA ("Voltalia").

- B. Voltalia ka krijuar një subjekt për qëllime të veçanta ("SPV") në Qendrën Kombëtare të Biznesit me emrin "Spitalla Solar" sh.p.k. dhe Pale e kesaj Marrëveshje Bashkëpunimi, me qëllim zbatimin e Projektit.
- C. Projekti do të ndërtohet në Bashkinë e Durrësit, në Spitallë në 13 parcela, të ndara nga njëra-tjetra me kanale dhe/ose rrugë për mirëmbajtje kanalesh, të identifikuara më së miri në Aneksin 2 të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi ("**Vendndodhja e Projektit**").
- D. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së MZHP dhe për qëllim të zhvillimit të Projektit, SPV i duhet të ketë nën kontrollin e saj administrimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, rrugëve dhe kanaleve të vendosura brenda Vendndodhjes së Projektit i identifikuar më së miri në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi ("**Rrjeti i Kullimit të Spitallës**").
- E. Rrjeti i Kullimit të Spitallës dhe të drejtat për të administruar, përdorur dhe mirëmbajtur atë ("**Të Drejtat e RRKS**") aktualisht i përkasin Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit pranë Bashkisë Durrës në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit", i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë faktet e sipërpërmendura, palët e kësaj Marrëveshje bien dakord për termat dhe kushtet si vijojnë:

Neni 1 Përkufizime

Në këtë Marrëveshje, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme do të kenë kuptimin që ju është dhënë në MZHP dhe më poshtë:

"**Data e Operacionit Tregtar**" nënkupton fillimisht orën 00:00 (ora vendore) të datës që vjen menjëherë pas datës në të cilën është kryer kolaudimi sipas MZHP, ose nëse është rënë dakord midis Palëve me shkrim, ditën e parë (1) të muaj që vjen menjëherë pas muajit në të cilin është kryer kolaudimi sipas MZHP.

"**Data e Hyrjes në Fuqi**" nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi;

"**Rrjeti i kullimit Spitalle**" ka kuptimin e përshkruar në pikën D të Kushteve Paraparaqe të kësaj Marrëveshjeje;

"**Të Drejtat e RRKS**" kanë kuptimin e përshkruar në pikën E të Kushteve Paraparaqe të kësaj Marrëveshjeje;

"**MIE**" ka kuptimin e përshkruar në pikën A të Kushteve Paraparaqe të kësaj Marrëveshjeje;

"**MZHP**" ka kuptimin e përshkruar në pikën A të Kushteve Paraparaqe të kësaj Marrëveshjeje;

"**MPZHP**" ka kuptimin e përshkruar në pikën A të Kushteve Paraparaqe të kësaj Marrëveshjeje;

"**Vendndodhja e Projektit**" ka kuptimin e përshkruar në pikën C të Kushteve Paraparaqe të kësaj Marrëveshjeje;



"SPV" ka kuptimin e përshkruar në pikën B të Kushteve Paraparakë të kësaj Marrëveshjeje;
"Kohëzgjatja e MZHP" nënkupton periudhë që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon tridhjetë (30) vjet pas datës së operacionit tregtar;
"Data e Transferimit" nënkupton datën e dorëzimit dhe e të drejtave të përdorimit të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit, nga Bashkia Durrës tek SPV;
"Vitalia" ka kuptimin e përshkruar në pikën A të Kushteve Paraparakë të kësaj Marrëveshjeje;
"Data e Fillimit të Punëve" do të thotë data në të cilën SPV do të fillojë punimet në terren në përputhje me MZHP, për këtë datë SPV do të njoftojë paraprakisht Bashkinë në përputhje me Nenin 2.3 të kësaj Marrëveshjeje;
"Punime" nënkupton të gjitha aktivitetet për planifikimin inxhinierik, ndërtimin dhe kolaudimin e Impiantit në përputhje me planin e zbatimit siç parashikohet në MZHP.

Neni 2

Objekti dhe Fusha e veprimit

- 2.1 Objekti i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është të sigurojë dhe përcaktojë modalitetet për të drejtën e **përdorimit të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit, nga Bashkia Durrës tek SPV.**
- 2.2 Bashkia merr përsipër të dorëzojë **Infrastrukturën e Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit** tek SPV, dhe SPV merr përsipër t'i pranojë ato, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.
- 2.3 Palët konfirmojnë dhe bien dakord që dorëzimi efektiv i **Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit**, nga Bashkia te SPV, do të bëhet në datën e fillimit të punimeve. SPV do të njoftojë Bashkinë për datën e fillimit të punimeve të paktën 1 (një) muaj përpara.

Neni 3

Baza Ligjore

- 3.1 Kjo marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në:
 - Ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.
 - Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar.
 - Ligjin Nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit".
 - VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit".
 - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 18.11.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të pronës shtetërore me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr. 2517



Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën Ish-Kënetës, Spitallë ndryshuar me VKM- në 478, datë 13.07.2022.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 06.04.2016 “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës”.
- Shkresa e MIE me nr. 4576/1 prot., datë 26.06.2025, protokolluar në bashkinë Durrës me Nr. 3032/3 Prot., datë 27.06.2025, nëpërmjet së cilës autorizohet bashkia Durrës për vijimin e procedurave të mëtejshme për nënshkriminin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Informacioni dhe Përshkrimi i Infrastruktursë së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit

4.1 Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit përbëhet nga:

- Të dhënat e pasurive të paluajtshme të transferuara në zbatim të Vëndimit të Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, inventari faqe 3,4 pjesë e kësaj Marrëveshjeje janë si më poshtë:
- (1) Kanali i dytë kullues KK-2 me bazë të madhe B=6m dhe bazë të vogël b=3m.
 - (2) Kanali i tretë kullues KK-3 me bazë të madhe B=4m dhe bazë të vogël b=2m.
- Pjerrësia për skarpatet për të dy llojet e kanaleve është 1:1.

Nr.	Kanalet e emërtuara sipas inventarit të ndërmarrjes Rruga	Lloji i Kanalit	Gjatësia e kanaleve (ml)	Distanca e lejuar për shërbim
1	Kanali 8/4	Kanali i tretë KK-3	700 ml	4-6 m
2	Kanali K8/8	Kanali i tretë KK-3	700 ml	4-6 m
3	Kanali K9/12	Kanali i tretë KK-3	700 ml	4-6 m
4	Kanali K8/18	Kanali i tretë KK-3	750 ml	4-6 m
5	Kanali K8/20	Kanali i tretë KK-3	750 ml	4-6 m
6	Kanali K-8	Kanali i tretë KK-2	600 ml	6-8 m
7	Kanali K10/4	Kanali i tretë KK-3	800 ml	4-6 m
8	Kanali K10/8	Kanali i tretë KK-3	800 ml	4-6 m
9	Kanali K10/12	Kanali i tretë KK-3	800 ml	4-6 m
10	Kanali K8/18	Kanali i tretë KK-3	750 ml	4-6 m
11	Kanali K/10	Kanali i tretë KK-2	600 ml	6-8 m
	Shuma Totale		7950 ml	



Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

5.1 Bashkia Durrës nëpërmjet Ndërmarrjes Rruga merr përsipër:

- 5.1.1 se është titullare e ligjshme e të drejtave të përdorimit të pronësisë së **Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë**, dhe se ai është nën administrimin e Bashkisë Durrës.
- 5.1.2 në datën e kalimit të të drejtës së përdorimit të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit, nga Bashkia Durrës tek SPV, kanalet sipas tabelës në nenin 4 të kësaj marrëveshje është i lirë nga çdo defekt, barrë apo pretendim i palëve të treta dhe Bashkia i garanton SPV përdorimin e tij dhe gëzimin paqësor gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Marrëveshje.
- 5.1.3 të paktën një herë në vit, ajo mund të kryejë inspektime periodike të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit, të përdorur nga SPV. Në raste të tilla, Bashkia do të njoftojë SPV të paktën 1 (një) muaj përpara inspektimit dhe të koordinojë me SPV për inspektimin aktual. Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e të dy Palëve do të jenë të pranishëm dhe do të shënojnë çdo gjetje të inspektimit në një procesverbal të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dy Palëve.
- 5.1.4 të mos ndërhyjë në administrimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit, përveç në rastet kur SPV nuk ka kryer detyrat e saj të administrimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit, pavarësisht njoftimit zyrtar paraprak të dërguar SPV-së nga Bashkia për një mospërmbushje të tillë duke i dhënë SPV të paktën 30 (tridhjetë) ditë për të korrigjuar mospërmbushjen. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore për sa me sipër bashkia Durrës merr masa duke vendosur sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.1.5 të dorëzojë Infrastrukturën e Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit tek SPV në kushte të mira dhe funksionale në datën e fillimit të punimeve. Për këtë qëllim, në datën e dorëzimit, palët do të veprojnë me mirëbesim dhe do të nënshkruajnë një procesverbal dorëzimi. Për të shmangur paqartësitë e mundshme, Palët pranojnë që deri në momentin e nënshkrimit të procesverbalit të dorëzimit posedimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, janë dhe do të mbeten në kompetencë të Bashkisë Durrës.
- 5.1.6 përgjatë Afatit të kësaj Marrëveshjeje, administrimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit jashtë Vendndodhjes së Projektit do të kryhet nga Bashkia ose palë të tjera të treta në mënyrë të tillë që të mos dobësojë ose dëmtojë Rrjetin e Kullimit të Spitallës, dhe në mënyrë të tillë që infrastruktura e ujitjes dhe kullimit në rrjedhën e poshtme të Vendndodhjes së Projektit të mirëmbahet dhe të funksionojë si duhet dhe vazhdimisht. Për të shmangur paqartësitë, SPV nuk do të mbajë përgjegjësi nga asnjë pretendim i palës së tretë ose pretendimeve të Bashkisë në lidhje me dëmet që mund të lindin për shkak të administrimit të pakujdesëm nga Bashkia dhe/ose ndonjë palë tjetër.



e tretë përgjegjëse për nfrastukturën e Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, jashtë Vendndodhjes së Projektit. Këto infrastruktura do të mirëmbahen në kushte të mira dhe funksionale.

5.2 SPV merr përsipër:

- 5.2.1 të marr në përdorim Infrastrukturën e Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit dhe të zbatojë të drejtat dhe detyrimet e dhëna asaj sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, me shpenzimet e veta dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar. Për të shmangur paqartësi, marrja në përdorim përfshin administrimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit.
- 5.2.2 të mos ndryshojë destinacionin e Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit. Në çdo rast, ajo mund të kryejë përmirësime të zakonshme gjatë administrimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes së Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit, siç parashikohet në nenin 5.2.1.
- 5.2.3 të mos ndërtojë ndonjë ndërtesë ose të mbjellë pemë në një distancë prej katër metrash nga bordura e kanalit të kullimit (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me pjerrësinë e kanalit të kullimit).
- 5.2.4 përgjatë Kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, ajo do të kryejë inspektime periodike të infrastrukturave ujëtare dhe kulluese që ndodhen në rrjedhën e Rrjetit të Kullimit të Spitallës. Në raste të tilla, SPV do të njoftojë Bashkinë të paktën 1 (një) muaj përpara për çdo inspektim dhe do të koordinojë me Bashkinë për inspektimin aktual. Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e të dy Palëve do të jenë të pranishëm dhe do mbajnë një procesverbal do të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dy Palëve dhe ku do të shënojë çdo gjetje të konstatuar gjatë inspektimit.
- 5.2.5 Nëse një vizitë në Vendndodhjen e Projektit zbulon një veprim që duhet ndërmarrë për të garantuar funksionimin e përsosur të infrastrukturave ujëtare dhe kulluese që ndodhen në rrjedhën e Rrjetit të Kullimit të Spitallës, Bashkia pranon të kryejë punimet e nevojshme brenda 2 jave nga data e njoftimit me shkrim nga SPV.
- 5.2.6 të dorëzojë Infrastrukturën e Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projektit dhe të transferojë të drejtat dhe detyrimet e dhëna asaj sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, pas mbarimit të Afatit të Marrëveshjes ose përfundimit të parakohshëm të saj, në të njëjtat kushte në të cilat ato ishin marrë duke përfshirë ndryshimet e zakonshme të bëra gjatë administrimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes së tij.

5.3 Palët bien dakord si vijon:

- 5.3.1 nëse një nga Palët identifikon rrezikun e përmytjes së Vendndodhjes së Projektit, ajo duhet të njoftojë Palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur dhe të kërkojë të zhvillojnë një takim.
- 5.3.2 brenda 2 (dy) javëve nga njoftimi i mësipërm, Palët do të mbajnë një takim për të diskutuar dhe rënë dakord mbi një plan veprimi për të shmangur rrezikun e përmytjes.



- 5.3.3 brenda afatit kohor të përcaktuar në planin e veprimt, por jo më vonë se 2 (dy) javë pas takimit, të dy Palët do të zbatojnë një plan veprimi, në përputhje me detyrat specifike të përcaktuara për secilën Palë në këtë plan.

Neni 6

Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të vazhdojë për një afat 10 vjeçar, me të drejtë rinovimi ndërmjet palëve dhe me të njëjtat kushte dhe terma.

Neni 7

Njoftimet

- 7.1 Çdo njoftim ose komunikim që Palët do t'i bëjnë njëra-tjetrës në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet se është dorëzuar në mënyrë të rregullt nëse dorëzohet personalisht, me postë rekomande ose me email tek personi i kontaktit në adresën e përcaktuar më poshtë (ose një adresë tjetër e njoftuar më pas në përputhje me këtë nen).
- 7.2 Të dhënat e njoftimit fillestar të palëve janë si më poshtë:
Për Bashkinë Durrës: _____
Adresa: Lagjia nr. 1, Sheshi "Liria", Durrës, Shqipëri
Email: info@durres.gov.al
Për SPV: _____
Adresa: Bulevardi "Bakram Curri", Ndërtesa ETC, H. 2, Kati 14,
Njësia Administrative Nr. 2, 1000, Tiranë, Shqipëri
Email: spitalla@vitalia.com
- 7.3 Në përputhje me nenin 7.1, çdo njoftim do të konsiderohet se është marrë:
(a) në rastin e dorëzimit me dorë, në momentin e dorëzimit;
(b) në rastin e postës rekomande, në ditën e dytë pas datës së postimit; dhe
(c) në rastin e postës elektronike, me dërgimin në serverin e marrësit dhe me kusht që dërguesi të mos marrë asnjë mesazh gabimi.

Neni 8

Forca Madhore

- 8.1 Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e kësaj Marrëveshjeje Bashkepunimi ose dëmtimin e shkaktuar njëra-tjetrës ose ndonjë pale të tretë për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore. Një "Ngjarje e Forcës Madhore" nënkupton një ngjarje ose rrethanë të jashtëzakonshme që një Palë as nuk mund ta parashikojë dhe as ta parandalojë me mjete të arsyeshme, duke përfshirë por pa u kufizuar fatkeqësitë natyrore, zjarri, luftë,



revolucionin, trazirat, kryengritje civile, shpronësim, nacionalizim, pandemi, shpërthim bërthamor, ndotje radioaktive ose kimike, ose rrezatim jonizues dhe rrethana të tjera që e kalojnë kontrollin e arsyeshëm të një Pale, me kusht që paaftësia paguese ose mungesa e mjeteve financiare nga ndonjëra prej Palëve nuk do të përbëjnë një Ngjarje të Forcës Madhore.

- 8.2 Nëse Pala e prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore është bërë plotësisht ose pjesërisht e paaftë në çdo kohë për të kryer detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkepunimi, ajo do të përjashtohet nga detyrimi për kryerjen e ciliësdo detyrë që është prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore në masën dhe për periudhën e prekur, me kusht që pala e prekur të njoftojë ("Njoftim për Forcë Madhore") palën tjetër ("Pala jo e Prekur") jo më vonë se shtatë (7) ditë pas ditës në të cilën pala e prekur është bërë e vetëdijshme ose duhet të ishte bërë e vetëdijshme se ka ndodhur një ngjarje e Forcës Madhore; Pala e prekur do të ndërmarrë menjëherë të gjitha hapat për të korrigjuar paaftësinë e saj për të përmbushur detyrimet e saj në përputhje me këtë Marrëveshje Bashkepunimi. Në rast se Ngjarja e Forcës Madhore vazhdon për më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë, SPV mund të kërkojë zgjidhjen e Marrëveshjes me anë të një njoftimi me shkrim pa pasur nevojë për të ndërmarrë ndonjë procedurë tjetër ligjore. Një përfundim i tillë i parakohshëm nuk cënon të drejtat dhe detyrimet e Palëve të ndodhura para datës së përfundimit, ose të drejtat e tjera të përfundimit të Marrëveshjes nga SPV sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Ligjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 9.1 Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Për çështjet që nuk rregullohen nga kjo Marrëveshje, Palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil Shqiptar dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.
- 9.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ngrihen midis Palëve në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen në me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres.

Neni 10

Të ndryshme

- 10.1 Secila nga Palët bie dakord të trajtojë si informacion konfidencial nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkepunimi dhe se nuk do ta përhapin tek palët e treta përmbajtjen e saj, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, përveç nëse kërkohet ndryshe nga ligji shqiptar dhe/ose huadhënësit e SPV.
- 10.2 Kjo Marrëveshje si dhe Aneksi (et) bashkëlidhur përbën/jnë marrëveshjen e plotë midis Palëve. Diskutimet paraprake; parashtrimet e bëra gjatë negociatave për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje përmban Aneksin (et) e mëposhtëm:

Shtojca 1: Harta treguese e rrjetit të kanalit kullues dhe ujitës objekt i Marrëveshjes;

Shtojca 2: Lista e Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vëndndodhjes së Palës;



- 10.3 Në rast se një ose disa dispozita të kësaj Marrëveshjeje Bashkepunimi dhe dokumentat e tjera të kërkuar apo dorëzuara nga Palët këtu, janë të pavlefshëm ose në kundërshtim me legjislacionin shqiptar ose do të bëhen të pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe ekzekutimi i dispozitave të tjera të Marrëveshjes nuk do të ndikohet apo humbasë fuqinë. Palët do të përpiqen në mirëbesim të hyjnë në bisedime për të zëvendësuar dispozitat e pavlefshme me dispozita të tjera të ligjshme, efekti i të cilave do të jetë i njëjtë ose i përafërt me efektin e këtyre dispozitave.
- 10.4 Çdo rregullim ose ndryshim në këtë Marrëveshje Bashkepunimi do të jetë e vlefshme nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dy Palët.
- 10.5 Kjo Marrëveshje do të regjistrohet në Regjistrin përkatës të Agjencisë Shtetërore të Kadastres brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i saj.
- 10.6 Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën Shqipe.
- 10.7 Kjo Marrëveshje hartohet në 5 (pesë) kopje, 1 kopje për noterin dhe 2 (dy) kopje për secilën Palë, të cilët pasi të bien dakord me njëra-tjetrën e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje, noterit publik.

BASHKIA DURRES

Përfaqësuar nga Kryetaria
Znj. Emiriana SAKO

SPITALLA SOLAR SH.P.K.

Përfaqësuar nga Country Manager
Znj. Kelly CLUTTERBUCK

Noteri



Shtojca 1

Harta treguese e rrjetit të kanalit kullues dhe
ujitës objekt i Marrëveshjes, koordinatat e
rrjetit të kanalit kullues



Shtojca 2

Lista e Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Spitallë, brenda Vendndodhjes së Projekti

Nr.	Kanalet e emërtuara sipas inventarit të ndërmarrjes Rruga	Lloji i Kanalit	Gjatësia e kanaleve (ml)	Distanca e lejuar për shërbim
1	Kanali 8/4	Kanali i tretë KK-3	700 ml	4-6 m
2	Kanali K8/8	Kanali i tretë KK-3	700 ml	4-6 m
3	Kanali K9/12	Kanali i tretë KK-3	700 ml	4-6 m
4	Kanali K8/18	Kanali i tretë KK-3	750 ml	4-6 m
5	Kanali K8/20	Kanali i tretë KK-3	750 ml	4-6 m
6	Kanali K-8	Kanali i tretë KK-2	600 ml	6-8 m
7	Kanali K10/4	Kanali i tretë KK-3	800 ml	4-6 m
8	Kanali K10/8	Kanali i tretë KK-3	800 ml	4-6 m
9	Kanali K10/12	Kanali i tretë KK-3	800 ml	4-6 m
10	Kanali K8/18	Kanali i tretë KK-3	750 ml	4-6 m
11	Kanali K/10	Kanali i tretë KK-2	600 ml	6-8 m
	Shuma Totale		7950 ml	





KOORDINATAT E PARCELAVE SIPAS HTR

Nr.	Parcela 46		Parcela 47		Parcela 48		Parcela 49		Parcela 50	
	E	N	E	N	E	N	E	N	E	N
1	454167.859	4582043.228	453996.789	4581947.870	453821.760	4581854.638	453653.304	4581764.929	453475.525	4581670.115
2	454527.236	4581375.870	454360.282	4581282.623	454185.808	4581184.253	454009.108	4581094.402	453833.722	4580998.638
3	454369.174	4581287.609	454196.588	4581190.334	454019.551	4581100.005	453940.634	4581002.406	453679.039	4580912.194
4	454007.495	4581953.844	453832.685	4581860.457	453661.793	4581769.452	453482.429	4581673.899	453317.685	4581586.134
Nr.	Parcela 63/1		Parcela 64/1		Parcela 65/1		Parcela 66/1			
	E	N	E	N	E	N	E	N		
1	453843.440	4580980.905	454016.060	4581075.211	454195.399	4581166.591	454369.205	4581266.241		
2	453689.529	4580894.909	453853.652	4580986.527	454025.187	4581080.187	454204.883	4581175.058		
3	454008.448	4580316.233	454165.994	4580399.102	454343.227	4580492.326	454522.831	4580589.561		
4	454158.297	4580395.053	454335.453	4580488.237	454512.916	4580581.892	454686.578	4580675.558		
Nr.	Parcela 63/2		Parcela 64/2		Parcela 65/2		Parcela 66/2			
	E	N	E	N	E	N	E	N		
1	454158.297	4580395.053	454335.453	4580488.237	454512.916	4580581.892	454686.578	4580675.558		
2	454008.448	4580316.233	454165.994	4580399.102	454343.227	4580492.326	454522.831	4580589.561		
3	454074.035	4580197.138	454229.062	4580280.489	454406.283	4580375.774	454586.351	4580472.589		
4	454221.929	4580276.654	454398.828	4580371.766	454575.453	4580466.730	454748.726	4580559.892		

Nr	Zona Kadastrale	Nr Pasune	Nomenklatura	Karteles sipas Pasunes
1	DR8517SP	46	K-34-87-(239-A)	42.500
2	DR8517SP	47	K-34-87-(239-A-B)	141.000
3	DR8517SP	48	K-34-87-(239-A)	141.250
4	DR8517SP	49	K-34-87-(239-A)	146.300
5	DR8517SP	50	K-34-87-(239-A-C)	135.400
6	DR8517SP	63/1	K-34-87-(239-B)	20.200
7	DR8517SP	63/2	K-34-87-(239-B)	26.600
8	DR8517SP	64/1	K-34-87-(239-B)	28.200
9	DR8517SP	64/2	K-34-87-(239-B)	28.035
10	DR8517SP	65/1	K-34-87-(239-D)	122.700
11	DR8517SP	65/2	K-34-87-(239-C)	25.030
12	DR8517SP	66/1	K-34-87-(239-C)	123.500
13	DR8517SP	66/2	K-34-87-(239-C)	25.020
				SIP M ² 1,298,810.00
				SIP ha 129.88



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 447/12 prot.

Durrës, më 03.07.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.36 datë 03.07.2025 ,” Për dhënien e miratimit të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Spitalla Solar Shpk me qëllim transferimin e të drejtës së përdorimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, kësaj shoqërie në funksion të ndërtimit të parkut fotovoltaik të Spitallës me një kapacitet prej 100 megavat energji”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

